



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT PËR KANDIDATËT PËR
KRYETAR BASHKIA DURRËS PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 27.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar Bashkia Durrës për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a" dhe neni 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN

Me vendimin nr. 32, datë 06.03.2015 "Për miratimin e disa rregullave për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore në KQZ", KQZ ka përcaktuar disa rregulla për mënyrën e regjistrimit të koalicioneve zgjedhore. Në përputhje me vendimin nr. 32 të KQZ, partitë politike depozituan respektivisht në KQZ marrëveshjet e tyre dhe KQZ me vendimet përkatëse ka miratuar regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019 dy koalicione zgjedhore, Koalicionin Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASE) dhe Koalicionin Shpresa për Ndryshim (SHN).

Gjithashtu jashtë koalicionit si parti që garon më vete për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, është regjistruar dhe partia Bindja Demokratike.



Nr. 660 i vendimit Data 27.05.2019 e vendimit Ora 18.00 e Vendimit

Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkia Durrës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Brenda afatit të përcaktuar në nenin 67, pika 1 dhe pika 2 të Kodit Zgjedhor, Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASE) depozitoi kërkesën për regjistrimin e znj. Valbona Sako si kandidate për kryetar Bashkia Durrës dhe Partia Bindja Demokratike depozitoi kërkesën për regjistrimin e znj. Valbona Sakollari.

KQZ miratoi me vendim regjistrimin e tyre, përkatësisht me vendimet nr. 398 datë 15.05.2019, vendimi nr. 600 datë 20.05.2019.

Në përfundim të procesit të regjistrimit të kandidatëve për Kryetar për zonën zgjedhore Bashkia Durrës, KQZ në mbështetje të nenit 98, pika 3 dhe 4, duhet të miratojë përmbajtjen e fletës së votimit për subjektet zgjedhore që garojnë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019.

Në mbledhjen e datës 27.05.2019 KQZ organizoi shortin sipas procedurave të përcaktuara në Udhëzimin nr. 3, datë 04.03.2015 "Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit".

Në përfundim të zhvillimit të shortit, rezultoi se, znj. Valbona Sakollari renditet e para dhe znj. Valbona Sako e dyta.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 98, pika 3, 4 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë përmbajtjen e fletës së votimit për Kandidat për Kryetar në zonën zgjedhore Bashkia Durrës, Qarku Durrës për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 660 i vendimit Data 27.05.2019 e vendimit Ora 18.00 e Vendimit

Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkia Durrës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.